



Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele

**PLANI VJETOR
PËR KRYERJEN E MBIKËQYRJES ADMINISTRATIVE NË VITIN 2025**

Në bazë të nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi 1 nënparagrafi 15¹, në lidhje me nenin 27 paragrafi 3 dhe neni 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18, 27/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 42 /20, 77/21 dhe 154/23), neni 29 i Ligjit për media (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/13 dhe 13/14) dhe neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 19 dhe neni 39 paragrafi 1 nënparagrafi 15 i Rregullores së punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) nr. 01-3732/1, datë 29.07.2019, dhe në pajtim me Konkluzionin e Këshillit të Agjencisë nr. 02-5193/12 datë 26.12.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale në seancën e 46-të, mbajtur më 25.12.2024, miratoi

PLAN VJETOR PËR KRYERJEN E MBIKËQYRJES ADMINISTRATIVE NË VITIN 2025

Mbikëqyrja administrative kryhet në punën e botuesve të mediave nga aspekti i pajtueshmërisë të punës së tyre me kushtet e përcaktuara në Ligjin për media, Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive dhe Rregulloret e miratuara në bazë të tij. Mbikëqyrja administrative mbi punën e botuesve të mediave të shkruara kryhet ekskluzivisht vetëm nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me detyrimet e përcaktuara në nenet 6, 8, 14 dhe 15 të Ligjit për Media.

Plani vjetor për mbikëqyrje administrative (në tekstin më tej: Plani vjetor) miratohet nga Këshilli i Agjencisë me propozim të drejtorit.

Sipas Ligjit për Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizuale, mbikëqyrja administrative mund të jetë e rregullt, e jashtëzakonshme dhe kontrolluese. Plani vjetor zbatohet vetëm për mbikëqyrjen e rregullt.

Gjatë planifikimit të fushëveprimit të aktiviteteve për mbikëqyrje të rregullt në këtë Plan Vjetor, merren parasysh: obligimet e Agjencisë që dalin nga Kodi zgjedhor për monitorimin e zgjedhjeve të rregullta lokale në vitin 2025; Plani vjetor për mbikëqyrjen e programit në vitin 2025; aktivitetet tjera të planifikuara në Programin e punës së Agjencisë; supozimet për mbikëqyrje të jashtëzakonshme që mund të lindin në bazë të kërkesave të personave juridikë ose fizikë ose të realizuara sipas detyrës zyrtare të Agjencisë; si dhe faktin se në pajtim me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, Agjencia ka obligim që pas çdo mase të shqiptuar, pasi të ketë kaluar afati i përcaktuar në aktin individual për shqiptimin e saj, të kryejë mbikëqyrje kontrolli.

¹Nënparagrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: Nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 248/18)

TRANSMETUESIT

Plani vjetor për mbikëqyrje të rregullt administrative në lidhje me përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga neni 14 i Ligjit për media dhe neni 51 dhe neni 97 i Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele përfshin: shërbimet programore në radio dhe televizion të Shërbimit publik radiodifuziv (TVM), transmetuesit me leje për punë në nivel shtetëror dhe një pjesë e radiodifuzerëve që transmetojnë programe në nivel rajonal dhe lokal.

Mbikëqyrja e rregullt administrative mbi përmbushjen e obligimeve nga neni 15 paragrafët 1, 3 dhe 5 të Ligjit për media dhe obligimet nga neni 62 paragrafi 6 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe nenet 9 dhe 21 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e lejes për transmetim në radio dhe televizion do të mbulojnë të gjithë transmetuesit komercial.

Mbikëqyrja e rregullt administrative

Pasqyrë e dispozitave ligjore që do t'i nënshtrohen mbikëqyrjes:

Neni 14 (Ligji për Media) Impresium

(1) Botuesi i medias është i obliguar në një vend të dukshëm për çdo bartës individualisht të përmbajtjes (për shembull, mostër e medias së shkruar, dhe emisioni televiziv) të sigurojë publikimin e të dhënave të mëposhtme:

- emrin dhe adresën e selisë dhe redaksisë së botuesit të medias,
- emrin e personit përgjegjës të botuesit të medias,
- emrin dhe mbiemrin e redaktorit përgjegjës, përkatësisht redaktorëve në pajtim me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe
- emrin dhe adresën e shtypshkronjës dhe datën e shtypjes ose ribotimit, si dhe numrin e kopjeve të shtypura, në rastin e medias së shkruar.

(2) Për transmetuesit obligimi nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohet në atë mënyrë që të dhënat të publikohen në fillim ose në fund të programeve audio/audiovizuele.

(3) Botuesi i medias është i obliguar në vendin e përshtatshëm për secilën përmbajtje të publikojë të dhënat e mëposhtme:

- emrin dhe mbiemrin e autorit të shtojcës së publikuar,
- emrin dhe mbiemrin e personit, gjegjësisht firmës bartëse të së drejtës autoriale për përmbajtjen e publikuar, me përjashtim të mediave të shkruara dhe programeve në radio,
- datën e prodhimit (muaji dhe viti) kur kemi të bëjmë me veprë audio/audiovizuele,
- origjina e veprës audio/audiovizuele dhe nëse vepra është krijuar nga prodhim i pavarur dhe informacione për të,
- emrin e personit juridik, përkatësisht emrin dhe mbiemrin e personit që ruan të mirat kulturore ose veprën arkivore, përkatësisht riprodhimin përkatës dhe
- emrin e botuesit të medias nga i cili është marrë shtojca e programit ose klip nga shtojca e programit, përveç nëse me marrëveshje të përbashkët nuk është rregulluar ndryshe.

Neni 15 (Ligji për Media) Publiciteti në punën e botuesve të medias

(1) Transmetuesit janë të obliguar deri më 31 mars të këtij viti në formular të veçantë të dhënë nga organi rregullaror kompetent të dorëzojnë të dhëna për:

- strukturën e pronësisë, pra të dhënat për emrin dhe selinë e personave juridikë ose emrin dhe vendbanimin e personave fizikë që janë pronar në aksione ose pjesë tek botuesi i medias, me të dhëna për përqindjen e aksioneve ose të pjesës që kanë blerë (fituar) dhe datën e blerjes,
- të dhëna për redaktorin/redaktorët përgjegjës,
- të dhëna për burimet e financimit të transmetuesit në vitin e kaluar (reklama, sponsorizime, shitje të përmbajtjeve, shërbime të ofruara palëve të treta, etj.),

- të dhënat për të ardhurat dhe shpenzimet totale të transmetuesit në vitin paraprak nga aktivitetet e siguruar dhe

- të dhëna për shikueshmërinë ose dëgjueshmërinë mesatare të transmetuesit në vitin e kaluar.

(2) Botuesit e mediave të shkruara janë të obliguar që të dhënat nga paragrafi (1) nënparagrafi 1 të këtij neni t'i publikojnë së paku në një gazetë ditore një herë në vit, më së voni deri më 31 mars të vitit aktual dhe prerje (fragment) nga publikimi të paraqesin tek organi rregullator kompetent në afat prej 15 ditëve nga data e publikimit.

(3) Transmetuesit janë të obliguar që të dhënat nga paragrafi (1) nënparagrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni t'i publikojnë në programin e tyre, së paku tri herë në vit, në kohën kryesore dhe regjistrimin e shpalljes t'ia dorëzojnë organi rregullativ kompetent në afat prej 15 ditësh nga dita e publikimit në mënyrën e përcaktuar nga organi rregullativ kompetent.

(4) Formularët nga paragrafi (1) i këtij neni publikohen në ueb faqen e organit rregullativ kompetent.

(5) Transmetuesit janë të obliguar organit rregullativ kompetent t'i paraqesin raport me shkrim, për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në lejen për transmetim në radio dhe televizion, e veçanërisht për zbatimin e konceptit programor, deri më 31 mars në vitin aktual. Krahas raportit dorëzohen edhe informata për mjetet teknike me të cilat transmetohet ose ritransmetohet shërbimi i tyre programor në Republikën e Maqedonisë ose jashtë vendit. Raporti me shkrim dorëzohet në formularin e përcaktuar nga organi rregullator kompetent.

(6) Organi rregullativ kompetent me shkrim do të paralajmëron botuesin e medias i cili nuk do t'i përmbush detyrimet e parapara me këtë nen dhe do t'i japë afat shtesë që nuk mund të jetë më i shkurtër se 45 ditë, në të cilin botuesi i medias do të jetë i obliguar t'i përmbushë detyrimet nga ky nen. Nëse botuesi i medias dhe në afatin shtesë nuk i përmbush obligimet e parapara me këtë nen, organi rregullativ kompetent do të heqë lejen e transmetimit në radio ose televizion në pajtim me Ligjin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

(7) Botuesi i medias së shkruara është i obliguar t'i dorëzojë Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Republikës së Maqedonisë një kopje të çdo numri të botuar të medias së shkruar pa pagesë.

(8) Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për shërbimin publik radiodifuziv.

Neni 51 (Ligji për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale) Informacioni i disponueshëm për përdoruesit

(1) Ofruesit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuale duhet t'u ofrojnë përdoruesve të tyre qasje të lehtë, të drejtpërdrejtë dhe të përhershëm në të paktën për të dhënat e mëposhtme:

- emrin e ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizuel, respektivisht emrin, shenjën mbrojtëse ose shenjën e shkurtuar identifikuese (avizo, logo, etj),
- adresën e selisë së ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizual,
- të dhënat për kontakt të ofruesit të shërbimit mediatik audio ose audiovizual (numër telefoni, e-mail adresë dhe/ose ueb-faqes, personi për kontakt të shpejtë, të drejtpërdrejtë dhe efikas) dhe
- nëse është e mundur dhe për organin rregullator kompetent.

(2) Shenjat e identifikimit duhet të vendosen vazhdimisht në të gjitha programet, dhe të transmetohen së paku një herë gjatë një ore reale të programit në radio.

(3) Ofruesit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuale mund të përdorin vetëm shenjat e tyre të identifikimit.

(4) Ofruesit e shërbimeve mediatike audio ose audiovizuale janë të detyruar për çdo ndryshim të shenjave të tyre identifikuese t'i dorëzojnë një kopje Agjencisë.

Neni 97 (Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale) Identifikimi i transmetuesit

(1) Transmetuesi duhet të ketë shenjën e tij identifikuese.

(2) Shenja identifikuese e transmetuesit duhet të vendoset vazhdimisht gjatë transmetimit të programit televiziv, dhe të transmetohet së paku një herë gjatë një ore reale të programit në radio.

(3) Në rastet kur radiodifuzeri transmeton program në një sistem të vetëm, gjatë kohëzgjatjes së këtij programi, ai është i detyruar edhe t'i nënvizojë shenjat e identifikimit.

(4) Transmetuesi nuk mund të përdorë shenjë identifikuese të ndryshme nga ajo e përcaktuar në licencë për kryerjen e veprimtarisë radiodifuzive.

(5) Transmetuesi për çdo ndryshim të shenjës identifikuese është i obliguar që një kopje të saj t'ia dorëzojë Agjencisë.

Neni 62 paragrafi 6 (Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale) Kushtet për sigurimin e transmetimit televiziv ose radio

Për sigurimin e transmetimit televiziv ose radio përveç kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë ligji, transmetuesi duhet të përmbush kushte të veçanta minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike në varësi nga formati programor, përcaktuar me akte nënligjore të miratuar nga Agjencia.

**Neni 9 (Rregullorja për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e licencës për transmetim në radio dhe televizion)
Numri dhe struktura e punonjësve**

Zotëruesi i licencës për transmetim në radio është i detyruar të ketë së paku:

10 (dhjetë) persona pjesëmarrës në krijimin e programit, nëse ka licencë për transmetim folës ose folës-muzikor në radio në nivel shtetëror;

7 (shtatë) persona pjesëmarrës në krijimin e programit, nëse ka licencë për transmetim muzikor ose radio muzikore-folëse në nivel shtetëror;

4 (katër) persona pjesëmarrës në krijimin e programit, nëse ka licencë për transmetim folës ose folës-muzikor në radio në nivel rajonal;

3 (tre) persona pjesëmarrës në krijimin e programit, nëse ka licencë për transmetim muzikor ose radio muzikore-folëse në nivel rajonal;

2 (dy) persona pjesëmarrës në krijimin e programit, nëse ka licencë për transmetimin e programit në nivel lokal, për zonë me mbi 50 000 banorë;

1 (një) person pjesëmarrës në krijimin e programit, nëse ka licencë për transmetimin e programi në nivel lokal, për zonë me më pak se 50 000 banorë.

Redaktori përgjegjës i shërbimit programor duhet të jetë në marrëdhënie të rregullt pune.

Personat e shënuar në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni duhet të punësohen nga transmetuesi me orar të plotë pune, në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e punës.

Personat pjesëmarrës në krijimin e programit janë gazetarë, spikerë, teknikë të pajisjeve për regjistrimin dhe transmetimin e zërit, redaktorë, si dhe persona të punësuar në vende të tjera të punës që lidhen drejtpërdrejt me krijimin e programit.

Përmbushja e kushteve minimale kadrovike dëshmohej me dorëzimin e dokumentit Fletparaqitje/Ç' regjistrim në sigurimin e detyrueshëm shoqëror - Formulari M1/M2 i dhënë nga Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut

**Neni 21 (Rregullorja për kushtet minimumale teknike, hapësinor, financiare dhe kadrovike për marrjen e licencës për transmetim në radio dhe televizion)
Numri dhe struktura e punonjësve**

Zotëruesi i licencës për transmetim televiziv të shërbimit programor të formatit të përgjithshëm është i detyruar, në marrëdhënie të rregullt pune, të ketë së paku:

70 (shtatëdhjetë) persona pjesëmarrës në krijimin e programit, nëse ka licencë për transmetim të programit në nivel shtetëror nëpërmjet një transmetuesi tokësor;

20 (njëzet) persona pjesëmarrës në krijimin e programit, nëse ka licencë për transmetim të programit në nivel shtetëror nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk përdor burim të kufizuar ose nëpërmjet një sateliti;

7 (shtatë) persona pjesëmarrës në krijimin e programit, nëse ka licencë për transmetim të programit në rajonin D1-Shkup;

5 (pesë) persona pjesëmarrës në krijimin e programit, nëse ka licencë për transmetim të programit në rajonet: D1-Crn Vrv - Veles, D2-Stracin, D3-Turtel, D4-Boskija, D5-Pelister, D6. -Mali Vllaj dhe D8 -Kodra e Diellit;

3 (tre) persona pjesëmarrës në krijimin e programit, nëse ka licencë për transmetim të programit në rajonin D7-Stogovë;

4 (katër) persona pjesëmarrës në krijimin e programit, nëse ka licencë për transmetim të programit në nivel lokal, për zonë me mbi 50 000 banorë;

3 (tre) persona pjesëmarrës në krijimin e programit, nëse ka licencë për transmetim të programit në nivel lokal, për zonë prej 30 000 deri në 50 000 banorë;

2 (dy) persona pjesëmarrës në krijimin e programit, nëse ka licencë për transmetim të programit në nivel lokal, për zonë me më pak se 30 000 banorë.

Zotëruesi i licencës për transmetim televiziv të shërbimit programor me format të specializuar është i detyruar në marrëdhënie të rregullt pune, të ketë së paku:

10 (dhjetë) persona nëse kanë licencë për transmetimin e programit në nivel shtetëror;

3 (tre) persona nëse ka licencë për transmetimin e programit në nivel rajonal;

1 (një) person nëse ka licencë për transmetimin e programit në nivel lokal.

Redaktori përgjegjës i shërbimit programor të formatit të përgjithshëm dhe të specializuar duhet të jetë në marrëdhënie të rregullt pune.

Personat e listuar në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni duhet të jenë të punësuar nga transmetuesi me orar të plotë pune, në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e punës.

Personat pjesëmarrës në krijimin e programit janë gazetarë, spiker (prezantues), teknikë të pajisjeve për regjistrimin dhe transmetimin e figurës dhe zërit, videografë, montues, si dhe persona të punësuar në vende të tjera të punës që lidhen drejtpërdrejt me krijimin e programit.

Plotësimi i kushteve minimale kadrovike dëshmohet me dorëzimin e dokumentit Fletparaqitje/Çregjistrim në sigurimin e detyrueshëm shoqëror - Formulari M1/M2 i dhënë nga Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Plani i mbikëqyrjes - llojet e transmetuesve dhe periudha e zbatimit:

Mbikëqyrja e rregullt administrative **për respektimin e detyrimeve nga nenet 14 të Ligjit për media dhe 51 dhe 97 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale** do të zbatohet mbi:

- Shërbimet programore televizive të Shërbimit publik radiodifuziv -
Në janar 2025;
- Shërbimet e programeve televizive komerciale kombëtare që transmetohen përmes ORRPKE-së –
Në mars 2025;

Shërbimet kombëtare të programeve televizive komerciale tokësore -
Në prill 2025;

Shërbimet kombëtare të programeve televizive satelitore komerciale -
Në mars 2025;

Shërbimet e programeve televizive komerciale rajonale - përzgjedhur prej nga 6
Në maj 2025;

Shërbimet e programeve televizive komerciale lokale – përzgjedhur prej nga 5
Në qershor 2025;

Shërbimet programore në radio të Shërbimit publik radiodifuziv –
Në shkurt 2025;

Shërbimet kombëtare të programeve të radios komerciale -
Në qershor 2025;

Shërbimet e programeve radio komerciale rajonale – përzgjedhur prej nga 5
Në nëntor 2025;

Shërbime të programeve radio jofitimprurëse -
Në dhjetor 2025.

Mbikëqyrja e rregullt administrative **për respektimin e obligimeve nga neni 15 paragrafi 5 i Ligjit për media** (raporti me shkrim për zbatimin e konceptit programor dhe kushtet e licencës) kryhet mbi të gjithë transmetuesit komercialë në bazë të të dhënave që janë të obliguar t'i dorëzojnë më së voni deri më 31 mars të vitit aktual dhe i referohen vitit të kaluar kalendarik.

Të gjithë transmetuesit komercialë -
Në prill 2025.

Mbikëqyrja e rregullt administrative për respektimin e obligimit nga neni 15 paragrafi 1 i Ligjit për Media do të zbatohet mbi:

Të gjithë transmetuesit komercialë -

Në prill 2025.

Mbikëqyrja e rregullt administrative për respektimin e obligimit nga neni 15 paragrafi 3 i Ligjit për Media do të zbatohet mbi:

Të gjithë transmetuesit komercialë -

Në prill, qershor dhe nëntor 2025.

Mbikëqyrja e rregullt administrative për respektimin e obligimeve nga neni 62 paragrafi 6 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele dhe nenet 9 dhe 21 të Rregullores për kushtet minimale teknike, hapësinore, financiare dhe kadrovike për marrjen e licencës për transmetim në radio dhe televizion do të realizohet mbi të gjithë transmetuesit, një herë në vit.

BOTUESIT E MEDIAS SË SHTYPIT

Mbikëqyrja administrative mbi botuesit e mediave të shkruara do të mbulojë obligimet që rrjedhin nga neni 14 paragrafi 1 dhe neni 15 paragrafi 2 të Ligjit për media.

Plani i mbikëqyrjes - botuesit e medias së shkruar dhe periudha e zbatimit:

Mbikëqyrja e rregullt administrative për respektimin e obligimit nga neni 14 paragrafi 1 i Ligjit për Media do të zbatohet mbi:

- Të gjithë botuesit e medias së shkruar –

Në shkurt, qershor dhe nëntor 2025.

Mbikëqyrja e rregullt administrative për respektimin e obligimit nga neni 15 paragrafi 2 i Ligjit për Media do të zbatohet mbi:

- Të gjithë botuesit e medias së shkruar –

Në prill 2025.

NR: 01-5301/1
26.12.2024
Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.